

VENDIM
Nr. 639, datë 2.10.2019

PËR
KALIMIN E SPORTELEVE TË SHËRBIMIT NË ADMINISTRIM TË
AGJENCISË SË OFRIMIT TË SHËRBIMEVE PUBLIKE TË INTEGRUARA
(ADISA)

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të pikës 2, të nenit 50, të ligjit nr.13/2016, “Për mënyrën e ofrimit të shërbimeve publike në sportel në Republikën e Shqipërisë”, me propozimin të Zëvendëskryeministrit, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Kalimin në administrim të Agjencisë së Ofrimit të Shërbimeve Publike të Integruara (ADISA) të sporteve të shërbimit ndaj qytetarit të:

- a) Drejtorisë së Përgjithshme të Tatimeve (DPT);
- b) Shërbimit Shtetëror të Gjendjes Civile;
- c) Agjencisë Kombëtare për Punësim dhe Aftësi (AKPA);
- ç) Fondit të Sigurimit të Detyrueshëm të Kujdesit Shëndetësor (FSDKSH);
- d) Institutit të Sigurimeve Shoqërore (ISSH);
- dh) Agjencisë Shtetërore të Kadastrës (ASHK).

2. Në rastet përjashtimore dhe me marrëveshje ndërmjet palëve, shërbimet, të cilat, për shkak të natyrës së tyre, nuk mund të ofrohen nga sportelet e ADISA-s, do të vazhdojnë të ofrohen drejtpërdrejt nga vetë institucioni.

3. Përjashtohen nga zbatimi i këtij vendimi, duke u ofruar drejtpërdrejt nga strukturat rajonale/vendore të Agjencisë Kombëtare për Punësim dhe Aftësi, shërbimet, si më poshtë vijon:

- a) informimi për punëkërkuesit, punëdhënësit dhe për çdo person të interesuar si pjesë e procesit të ndërmjetësimit;
- b) ndërmjetësimi për punësim;
- c) këshillimi dhe orientimi për karrierë, punësim e profesion.

4. Shërbimet e gjendjes civile do të ofrohen njëkohësisht nga ADISA dhe nga Shërbimi Shtetëror i Gjendjes Civile, sipas përcaktimeve të legjislacionit në fuqi për gjendjen civile.

5. Punonjësit aktualë të Drejtorisë së Përgjithshme të Tatimeve (DPT), të cilët ushtrojnë funksionin e sportelit, kalojnë si punonjës të Agjencisë së Ofrimit të Shërbime Publike të Integruara (ADISA).

6. Aplikimi për marrjen e shërbimeve të institucioneve të parashikuara në pikën 1, të këtij vendimi, nga ADISA, do të kryhet sipas procedurave të parashikuara në ligjin nr.13/2016, datë 18.2.2016, “Për mënyrën e ofrimit të shërbimeve publike në sportel në Republikën e Shqipërisë”, si dhe sipas parashikimeve të legjislacionit sektorial që rregullon dhënien e këtyre shërbimeve publike. Për një rregullim më të detajuar, ADISA dhe institucionet e përcaktuara në pikën 1, të këtij vendimi, mund të nënshkruajnë një marrëveshje bashkëpunimi, në të cilën detajohen format, procedurat e mënyrat e bashkëpunimit.

7. Për ato njësi vendore në të cilat ADISA nuk ka sportele shërbimi, deri në ngritjen e tyre, këto shërbime do të ofrohen nga vetë institucionet e administratës shtetërore të përcaktuara, sipas pikës 1, të këtij vendimi. Me përjashtim të sporteve që ofrojnë shërbimet e parashikuara sipas pikave 2, 3 dhe 4, të këtij vendimi, me ngritjen e sporteve të ADISA-s, sportelet e institucioneve të administratës shtetërore në ato njësi vendore, përfshirë edhe zyrat vendore të ASHK-së, mbyllen.

8. Vendimet e Këshillit të Ministrave nr. 640, datë 7.9.2016, “Për kalimin e sporteleve të shërbimit të Fondit të Sigurimit të Detyrueshëm të Kujdesit Shëndetësor në administrim të Agjencisë së Ofrimit të Shërbimeve Publike të Integruara (ADISA)”, i ndryshuar; nr. 715, datë 5.12.2018, “Për kalimin e sporteleve të Institutit të Sigurimeve Shoqërore në administrimin e Agjencisë së Ofrimit të Shërbimeve Publike të Integruara (ADISA)”, dhe nr. 757, datë 26.10.2016, “Për kalimin e sporteleve pritëse për qytetarët të Zyrave Vendore të Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme në administrimin e Agjencisë së Ofrimit të Shërbimeve Publike të Integruara”, i ndryshuar, shfuqizohen.

9. Ngarkohen Agjencia e Ofrimit të Shërbimeve Publike të Integruara (ADISA), Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve, Shërbimi Shtetëror i Gjendjes Civile, Agjencia Kombëtare për Punësim dhe Aftësi, Fondi i Sigurimit të Detyrueshëm të Kujdesit Shëndetësor, Instituti i Sigurimeve Shoqërore dhe Agjencia Shtetërore e Kadastrës për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTËR
Edi Rama